


GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
Ap-Kz nr. 110/2011
6 nëntor 2012



GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarëve **Horst Pfoeter** si Kryetar i kolegjit dhe gjyqtarëve **Tore Thomassen**, **Emine Kadiku**, **Marije Ademi**, dhe **Avdi Dinaj** si anëtarë të kolegjit, në praninë e **Chiara Rojek** e cila vepron në cilësinë e procesmbajtëses,

Në procedurën penale kundër të pandehurit **O. Z.** emri i të atit **S.** emri i nënës **[redacted]** i lindur më **[redacted]** në fshatin **[redacted]** komuna e **Rahovecit**, me shtetësi të Kosovës, adresa e fundit e banimit, rruga **[redacted]** ish biznesmen,

I akuzuari sipas aktakuzës PP nr. 230/2005 të ngritur më 17 korrik 2007 nga Prokurori Publik i Qarkut në Prizren kundër të pandehurve **O. Z.** dhe **S. S.** duke i akuzuar për veprat penale të Vrasje e Rëndë në bashkëkryerje në kundërshtim të Nenit 147 pikat 4, 5 dhe 8 të lexuar me Nenin 23 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK) (pika 1), Vrasje në Tentativë në bashkëkryerje në kundërshtim të Nenit 147 pika 11 të lexuar me Nenin 20 dhe 23 të KPPK (pika 2), Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të Nenit 328 Paragrafët 1 dhe 2 të KPPK (pika 3), dhe për të pandehurin **O. Z.** vetëm, me veprën penale të Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim me Nenin 328 Paragrafi 2 të KPPK (pika 4),

I dënuar në shkallën e parë me aktgjykimin P nr. 155/2007 të Gjykatës së Qarkut në Prizren të datës 17 prill 2008 për veprat penale të Vrasje e Rëndë në bashkëkryerje në kundërshtim të Nenit 147 pika 5 të KPPK të lexuar me Nenin 23 të KPPK, Vrasje e Rëndë në Tentativë në bashkëkryerje në kundërshtim të Nenit 147 pika 11 të lexuar me Nenin 20 dhe 23 të KPPK Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të Nenit 328 Paragrafi 1 të KPPK, dhe Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të Nenit 328 Paragrafi 2 të KPPK, dhe i dënuar me një dënim unik prej njëzet e pesë (25) vjet burgim, I konfirmuar në shkallën e dytë me aktgjykimin Ap-Kz nr. 481/2008 të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 21 korrik 2009, përveç modifikimit të emërtimeve ligjor nën pikat 1, 2 dhe 3,¹

Duke vepruar sipas aktgjykimit Api-Kzi nr. 09/2009 të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 28 dhjetor 2010, e cila vepron si gjykatë e shkallës së tretë, me të cilin është anuluar aktgjykimi i shkallës së dytë Ap-Kz nr. 481/2008 dhe lënda është kthyer në gjykatën e shkallës së dytë për rigjykim, dhe duke pasur parasysh mendimin e Zyrës së Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPShK) të paraqitur më 16 mars 2011,

¹ Cilësimet ligjore nën pikat 1 dhe 2 janë unifikuar dhe cilësuar si Vrasje e Rëndë në shkelje të Nenit 147 pika 5 të KPPK; dhe cilësimi ligjor nën pikën 3 është modifikuar në Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve në shkelje të Nenit 328 Paragrafi 2 të KPPK.



Pas mbajtjes së një seance dhe zhvillimit të seancës dëgjimore për të marrë prova në praninë e të pandehurit O [REDACTED] Z [REDACTED] avokatit të tij mbrojtës E [REDACTED] R [REDACTED], B [REDACTED] dhe L [REDACTED] S [REDACTED], Prokurorit të EULEX-it Judit Tatrai e cila përfaqëson ZPShK dhe pas mbajtjes së këshillimit dhe votimit më 6 nëntor 2012,

Në pajtueshmëri me Nenet 411 dhe tutje të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), lëshon këtë,

AKTGJYKIM

1. I pandehuri O [REDACTED] Z [REDACTED] me të dhëna personale më lart, **SHPALLET FAJTOR** për veprën penale të **Vrasje** në bashkëkryerje në kundërshtim të Nenit 146 të KPPK të lexuar me Nenin 12 Paragrafi 2 dhe Nenin 23 të KPPK (pika 1) dhe për **Vrasje në Tentativë** në bashkëkryerje në kundërshtim të Nenit 146 të lexuar me Nenin 20, Nenin 23 dhe Nenin 12 Paragrafi 2 të KPPK (pika 2), të ndëshkueshme nën Nenin 147 Paragrafi 1 pika 11 të KPPK
Sepse
Më 10 tetor 2005 rreth orës 16:20 në tregun e fshatit X [REDACTED], komuna e Prizrenit, O [REDACTED] Z [REDACTED] duke vepruar në marrëveshje me bashkëkryerës të panjohur me synim për të privuar qëllimisht nga jeta një person tjetër, respektivisht H [REDACTED] R [REDACTED] me dashje ka shtënë në dhe ka vvarë H [REDACTED] dhe me synim për tu përpjekur qëllimisht të privoj nga jeta një person tjetër, respektivisht M [REDACTED] me dashje ka shtënë në dhe plagosi [REDACTED] n.r.
2. Vepra penale e **Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve** në kundërshtim të Nenit 328 Paragrafët 1 dhe 2 të KPPK (pika 3) është përfshirë nën pikat 1 dhe 2.
3. I pandehuri O [REDACTED] Z [REDACTED] me të dhëna personale më lart, **SHPALLET FAJTOR** për veprën penale të **Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve** në kundërshtim të Nenit 328 Paragrafi 2 të KPPK (pika 4)
Sepse
Më 19 prill 2007 kur është arrestuar nga policia, ai ishte në posedim të një arme për të cilën nuk kishte autorizim për posedim apo shfrytëzim.
4. Prandaj i akuzuari O [REDACTED] Z [REDACTED] **DËNOHET** me sa vijon:
 - me katërbëdhjetë (14) vjet burgim në pajtueshmëri me Nenin 146 të lexuar me Nenin 12 Paragrafi 2, Nenin 23 dhe Nenin 147 Paragrafi 1 pika 11 të KPPK, pasi që në kohën e kryerjes së veprës penale ishte në gjendje të aftësisë të zvogëluar mendore (pikat 1 dhe 2), dhe
 - me dy (2) vjet burgim në pajtueshmëri me Nenin 328 Paragrafi 2 të KPPK (pika 4).
5. Një dënim unik prej pesëmbëdhjetë (15) vjet burgim është shqiptuar ndaj të pandehurit O [REDACTED] Z [REDACTED] në pajtueshmëri me Nenin 71 të KPPK.
6. Koha e kaluar në paraburgim nga O [REDACTED] Z [REDACTED] do të llogaritet që nga 19 prill 2007 në pajtueshmëri me Nenin 73 të KPPK.
7. Propozimi i mbrojtjes i paraqitur më 6 nëntor 2012 për të ndërprerë paraburgimin për O [REDACTED] Z [REDACTED] **REFUZOHET** si i pabazuar.



ARSYETIM

I. Procedura e deritanishme lidhur me këtë lëndë

1. Më 17 korrik 2007, prokurori publik i qarkut të Prizrenit ka ngritur aktakuzën PP nr. 230 / 2005² ndaj të pandehurve O [redacted] Z [redacted] dhe S [redacted] S [redacted] për veprat penale të vrasjes së rëndë në bashkëkryerje në kundërshtim me nenin 147, pikat 4, 5 dhe 8, lidhur me nenin 23 të KPK-së, të vrasjes në tentativë në bashkëkryerje, në kundërshtim me nenin 147, pikën 11, lidhur me nenet 20 dhe 23 të KPK-së dhe të mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me nenin 328, par. 1 dhe 2 të KPK-së. O [redacted] Z [redacted] po ashtu është akuzuar edhe për veprën e mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me nenin 328, par. 2 të KPK-së.

2. Më 30 gusht 2007, është konfirmuar përmes aktvendimit përkatës aktakuza KA nr. 112/2007.³

3. Shqyrtimi gjyqësor ka filluar në janar 2008. Më 17 prill 2008, Gjykata e Qarkut të Prizrenit, përmes aktvendimit të saj P nr. 155 / 2007, ka shpallur fajtorë të dy të pandehurit për veprat penale të:

- vrasjes së rëndë në bashkëkryerje në kundërshtim me nenin 147, pikën 5 të KPPK-së, lidhur me nenin 23 të KPK-së (pika 1),⁴
- vrasjes së rëndë në bashkëkryerje në tentativë, në kundërshtim me nenin 147, pikën 11, lidhur me nenet 20 dhe 23 të KPK-së (pika 2),⁵ si dhe të
- mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me nenin 328, par. 1 të KPK-së (pika 3).⁶


² Dosja e kaltër, Gjykata e Qarkut në Prizren HEP 52 / 2007, PP 230 / 05, lënda 128 / 05, O [redacted] Z [redacted] dhe S [redacted] S [redacted] procedura paraprake I: aktakuza PP nr. 230 / 2005 i datës 17 korrik 2007

³ Dosja e kaltër, Gjykata e Qarkut në Prizren KA 112 / 2007, O [redacted] Z [redacted] dhe S [redacted] S [redacted] vëllimi V, aktvendimi KA nr. 112 / 2007 mbi konfirmimin e aktakuzës, i datës 30 gusht 2007

⁴ "Për shkak se më datën 10 tetor 2005 rreth orës 16:20 në tregun e fshatit Xërxë të komunës së Prizrenit, O [redacted] Z [redacted] duke vepruar në bashkëpunim me bashkëkryerësin S [redacted] S [redacted] me qëllim të privimit të qëllimshëm nga jeta të personit [redacted], qëllimisht kanë shtënë dhe kanë vrarë viktimën [redacted] H. R. përderisa kanë qenë të pranishëm edhe personat e tjerë duke demonstruar në atë mënyrë shpërtillje të pamëshirshme për jetën në mënyrë të dhunshme;"

⁵ "Për shkak se më datën 10 tetor 2005 rreth orës 16:20 në tregun e fshatit Xërxë të komunës së Prizrenit, O [redacted] Z [redacted] duke vepruar në bashkëpunim me bashkëkryerësin S [redacted] S [redacted] me qëllim të privimit të qëllimshëm nga jeta të personit [redacted], qëllimisht kanë shtënë dhe kanë plagosur viktimën [redacted] përderisa kanë qenë të pranishëm edhe personat e tjerë duke demonstruar në atë mënyrë shpërtillje të pamëshirshme për jetën në mënyrë të dhunshme;"

⁶ "Për shkak se më datën 10 tetor 2005 rreth orës 16:20 në tregun e fshatit Xërxë të komunës së Prizrenit, O [redacted] Z [redacted] duke vepruar në bashkëpunim me bashkëkryerësin S [redacted] S [redacted] me qëllim të privimit të qëllimshëm nga jeta të personit [redacted], dhe duke tentuar qëllimisht që ta privojnë nga jeta viktimën Nazem Rustemi, kanë shtënë qëllimisht mbi viktimat H [redacted] dhe N [redacted] në posedim dhe në shfrytëzim të paautorizuar të armës për të cilën nuk kishte qenë i autorizuar apo ta shfrytëzojë;"



Përveç kësaj, O [REDACTED] Z [REDACTED] është shpallur fajtor edhe për veprën penale të mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me nenin 328, par. 2 të KPK-së (pika 4).⁷

4. Kundër të dy të pandehurve është shqiptuar dënimi unik prej njëzet e pesë (25) vjetësh burgim.⁸

5. Më 4 gusht 2008, avokatët mbrojtës E [REDACTED] R [REDACTED] dhe R [REDACTED] C [REDACTED] kanë parashtruar ankesa në emër të O [REDACTED] Z [REDACTED] ndaj aktgjykimit P. Nr. 155 / 2007, ndërsa më 1 dhjetor 2008, prokurori i shtetit ka paraqitur opinionin e vet si dhe propozimin lidhur me këto ankesa, duke propozuar që të njëjtat të refuzohen si të pabaza.

6. Më 29 tetor 2008, avokati mbrojtës E [REDACTED] R [REDACTED] ia ka dërguar gjykatës një letër të të pandehurit dhe ka kërkuar nga ta që t'ia bashkëngjisin ankesës. Në atë letër, O [REDACTED] Z [REDACTED] ka deklaruar se pranon se kishte vrarë viktimën [REDACTED] si dhe kishte plagosur vëllain e viktimës në fshatin [REDACTED] më datën 10 tetor 2005, dhe se kishte qenë personi i vetëm i përfshirë në këtë rast. Për më tepër, ai kishte kërkuar që lënda në fjalë të kthehej në rigjykim. H.R.

7. Më 21 korrik 2009, Gjykata Supreme e Kosovës kishte nxjerrë aktgjykimin Ap - Kz 481 / 2008, me të cilin kishte pranuar në mënyrë të pjesshme ankesën e parashtruar nga i pandehuri O [REDACTED] Z [REDACTED] Gjykata e shkallës së dytë kishte bashkuar cilësimet juridike të pikave 1 dhe 2 (vrasje e rëndë në bashkëkryerje, në kundërshtim me nenin 147, pikën 5, lidhur me nenin 23 të KPK-së si dhe vrasje e rëndë në tentativë, në kundërshtim me nenin 147, pikën 11, lidhur me nenet 20 dhe 23 të KPK-së) për vrasje të rëndë në bashkëkryerje, në kundërshtim me nenin 147, pikën 11, lidhur me nenin 23 të KPK-së, dhe ka ndryshuar cilësimin juridik sipas pikës 3 (mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim apo në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me nenin 328, par. 1 të KPK-së) në mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim apo në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me nenin 328, par. 2 të KPK-së. Gjykata e shkallës së dytë ka shfajësuar të pandehurin e dytë S [REDACTED], duke e liruar të njëjtin nga të gjitha akuzat.

8. Më 2 shtator 2009, avokati mbrojtës E [REDACTED] R [REDACTED] ka parashtruar në emër të të pandehurit O [REDACTED] Z [REDACTED] një ankesë ndaj aktgjykimit Ap - Kz nr. 481 / 2008 për shkak të

⁷ "Për shkak se më datën 19 prill 2007, kur ishte arrestuar nga policia, kishte qenë në posedim të armës për të cilën nuk kishte pasur autorizim që ta posedojë apo ta shfrytëzojë;"

⁸ I pandehuri Z [REDACTED] ishte dënuar me burgim në kohëzgjatje prej njëzet e pesë (25) vjetësh sipas pikës 1, me njëzet e pesë (25) vjet sipas pikës 2, me gjashtë (6) vjet sipas pikës 3 dhe me tre (3) vjet sipas pikës 4. Përveç kësaj, Gjykata e Qarkut ka urdhëruar konfiskimin dhe asgjësimin e revoles Amadeo Rossi S.A. 0.38 Special; pastaj ka urdhëruar që të pandehurit t'i mbulojnë shpenzimet e procedurës penale, duke përfshirë këtu edhe shumën prej 850.00 eurosh N [REDACTED] për pagat e humbura gjatë mbajtjes së gjykimit; që secili nga të pandehurit të paguajë veçmas paushallin gjyqësor pa kamatë në vlerë prej 200 eurosh brenda afatit prej 15 ditësh prej ditës kur aktgjykimi në fjalë të hyjë në fuqi; që secili nga të pandehurit të paguajë shpenzimet veta përkatëse të transportit dhe të përcjelljes si dhe t'i paguajë avokatit përkatës mbrojtës [REDACTED] dhe shpenzimet e domosdoshme; që të pandehurit në mënyrë të përbashkët dhe ndaras të paguajnë [REDACTED] tjera. Gjykata e Qarkut ka urdhëruar publikimin e aktgjykimit të formës së prerë në bazë të nenit [REDACTED] të [REDACTED] që ka udhëzuar palën e dëmtuar N [REDACTED] që ta ngritë padinë përmes procedurës civile.



shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 403 të KPPK-së, për shkak të shkeljeve të ligjit penal sipas nenit 404 të KPPK-së, për shkak të vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike sipas nenit 405 të KPPK-së si dhe për shkak të vendimit mbi dënimin sipas nenit 405 të KPPK-së. I njëjti propozon që Gjykata Supreme ta ndryshojë aktgjykimin e kontestuar ashtu që të ta lirojë të pandehurin, apo ta anulojë të njëjtin dhe ta kthejë lëndën në rigjykim. Më 3 shtator 2009, avokati mbrojtës F. [REDAKTUAR] po ashtu ka parashtruar ankesë në emër të O. [REDAKTUAR] Z. [REDAKTUAR] për të njëjtat shkaqe. Më datën 10 shtator 2009, avokati mbrojtës Tomë Gashi ka paraqitur ankesë në emër të O. [REDAKTUAR] Z. [REDAKTUAR] për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe vendimit të gabuar mbi dënimin. I njëjti i propozon Gjykatës Supreme të Kosovës që ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë dhe ta kthejë lëndën në rigjykim, ose ta ndryshojë cilësimin juridik të veprës penale dhe shqiptimin e një dënimi më të lehtë. Më 25 janar 2010, prokurori special ka paraqitur opinionin dhe propozimin e vet lidhur me ankesat në fjalë, duke kërkuar vërtetimin e aktgjykimin të kontestuar.

9. Më 28 dhjetor 2010, Gjykata Supreme e Kosovës, duke vepruar si gjykatë e shkallës së tretë, ka nxjerrë aktgjykimin Api - Kzi nr. 09 / 2009 me të cilin pranohen në mënyrë të pjesshme ankesat e parashtruara në emër të O. [REDAKTUAR] Z. [REDAKTUAR]. Aktgjykimin i gjykatës së shkallës së dytë Ap - Kz nr. 481 / 2008 u anulua ndërsa lënda u kthye për rigjykim në gjykatën e shkallës së dytë.

II. Kompetencat dhe procedura pranë Gjykatës Supreme të Kosovës

10. Gjykata Supreme e Kosovës është gjykatë kompetente për të vendosur rreth ankesave në bazë të neneve 26, par. 1 dhe 398 të KPPK-së. Kolegji është formuar në përputhje me Ligjin nr. 03 / L – 53 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve për gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it në Kosovë, të datës 13 mars 2008 dhe në përputhje me udhëzimet për caktimin e gjyqtarëve të EULEX-it në lëndët penale të Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 24 mars 2011.

11. Gjykata Supreme është e mendimit se duke pasur parasysh gjetjet e aktgjykimin të shkallës së tretë, të katër çështjet janë të përcaktuara me fushëveprimin e procedimit të këtyre ankesave: natyra e letrës së O. [REDAKTUAR] Z. [REDAKTUAR] e adresuar gjykatës më 29 tetor 2008, ekzistimi i përgjegjësisë penale, cilësimi juridik i veprave të kryera dhe dënimi penal i shqiptuar ndaj të pandehurit. Në aktgjykimin e saj Api - Kzi nr. 09 / 2009, Gjykata Supreme e Kosovës, ka arritur gjer tek këto përfundime:

0.2. "33. Për arsyet e cekura më sipër, Gjykata Supreme konstaton se ankesat e mbrojtjes së të pandehurit [REDAKTUAR] janë pjesërisht të bazuara.

Kjo në veçanti i referohet pranimit të mundshëm të vrasjes së [REDAKTUAR] dhe vrasjes në tentativë të N. [REDAKTUAR] nga ana e të pandehurit O. [REDAKTUAR] Z. [REDAKTUAR] lidhur me atë se procedura ligjore nuk është zhvilluar në pajtim me KPPK-në nga ana e trupit gjykues të gjykatës së shkallës së dytë (lexo pikën A. IV të këtij aktgjykimin). Për më tepër, gjykata e shkallës së dytë nuk ka bërë ekzaminimin e kësaj çështjeje, pra nëse i pandehuri O. [REDAKTUAR] Z. [REDAKTUAR] ka qenë apo jo përgjegjës nga aspekti penal në kohën kur janë kryer veprat penale në fjalë, përkatësisht kur janë qëlluar H. [REDAKTUAR] dhe N. [REDAKTUAR]. Për këtë arsye, janë shkelur neni 415, par. 1, pika 2, lidhur me nenin 404, pikën 2 të KPPK-së, pasi që ekzaminimi e sidomos ekzaminimi i kryer nga trupi gjykues i shkallës së dytë duhet të bëhet sipas detyrës zyrtare pra *ex officio*, sa herë që një gjë e tillë të përcaktohet për lëndën në fjalë (lexo pikën III të këtij aktgjykimin). Për të gjitha arsyet e përmendura deri më tani, aktgjykimin



shkallës së dytë, duhet të anulohet nga Gjykata Supreme si dhe lënda duhet të kthehet prapa në gjykatën e shkallës së dytë për t'u rishqyrtuar dhe për t'u rigjykuar edhe një herë.

H.R. E fundit por jo më pak e rëndësishme, Gjykata Supreme e Kosovës ka konstatuar se cilësimi juridik i vrasjes së [redacted] dhe i plagosjes së N. [redacted] duhet të marrë parasysh çështjen e paramendimit dhe qëllimin e kryerësit, për të cilat gjykata e shkallës së dytë nuk ka diskutuar fare. Paramendimi është një formulim i keq i përdorur në versionin në gjuhën angleze të ligjit të vjetër – duhet të shikohet versioni origjinal.

Në fund, rishqyrtimi i këtyre çështjeve të përmendura më lart mund të shpie edhe deri tek nevoja e rivlerësimit të dënimit të shqiptuar..."⁹

12. Më 14 nëntor 2011, duke vepruar sipas detyrës zyrtare, në bazë të neneve 176, 191 dhe 360 të KPPK-së dhe pas rekomandimeve të gjykatës së shkallës së tretë, kryetari i kolegjit në këtë lëndë ka nxjerrë urdhrin Ap - Kz nr. 110 / 2011, me të cilin duhet të kryhej ekspertiza psikiatrike e O. [redacted] Z. [redacted] në Klinikën e Psikiatrisë së [redacted] Universitare të Kosovës. Një urdher i tillë pastaj është ndryshuar më datën 12 mars 2012.

13. Komisioni i ekspertëve i cili ka kryer ekspertizën ka qenë i përbërë nga doktor [redacted] (psikiatër) doktoresha [redacted] (psikiatër) dhe [redacted]. Raporti i super ekspertizës së O. [redacted] Z. [redacted] është dorëzuar në shkrimoren e gjykatës më datën 6 shtator 2012 dhe u është komunikuar palëve. Njëri nga anëtarët e këtij komisioni, doktori [redacted] është ftuar në gjykatë për të dhënë sqarimet e mëtejshme lidhur me gjetjet e kësaj super ekspertize.

14. Gjatë seancës gjyqësore të datës 6 nëntor, avokatët mbrojtës kanë bërë një parashtrësë në të cilën kanë adresuar çështjet në fjalë duke propozuar që lënda të mos kthehet përsëri në rigjykim. Ata kanë propozuar mbajtjen e një seance dëgjimore e cila do të mbahej me qëllim të ofrimit të mundësisë O. [redacted] Z. [redacted] për ta sqaruar letrën, faktet të cilat kanë ndodhur si dhe motivet e tij. Ata kanë kërkuar që Gjykata Supreme e Kosovës ta lirojë të njëjtin për shkak të mungesës së përgjegjësisë penale apo ta shpallë fajtor për vrasje. Në këtë letër të tyre, mbrojtja sugjeron zbatimin e nenit 12, par. 2 të KPK-së lidhur me aftësinë e zvogëluar mendore dhe / ose cilësimin e veprës penale në bazë të nenit 148 të KPK-së, përkatësisht cilësimin e kësaj vepre si vrasje e kryer në gjendje të afektit mendor.

15. Duke i marrë parasysh të gjitha këto që u thanë deri më tani, kolegji i Gjykatës Supreme vendos të mbajë një seancë dëgjimore për pranimin e provave të reja pasi që ishin plotësuar kushtet e përcaktuara me nenin 412, par. 1 të KPPK-së.

III. Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

III.A. Letra e të pandehurit O. [redacted] Z. [redacted] datës 25 tetor 2008

16. Më 29 tetor 2008, në gjykatë ishte komunikuar një letër e O. [redacted] Z. [redacted] e datës 25 tetor nga avokati i tij mbrojtës. Në këtë letër, ai pranon se e ka vrarë [redacted] dhe se e ka plagosur vëllain e tij dhe se ai është personi i vetëm përgjegjës.¹⁰ H.R.

⁹ Gjykata Supreme e Kosovës, Api - Kzi nr. 09 / 2009, lënda O. [redacted] Z. [redacted] aktgjyqësor i Gjykatës së [redacted] shkallës së tretë, i datës 28 dhjetor 2010, faqe 24, paragrafi 33



17. Në aktgjykimin Ap-Kz nr. 481/2009, Gjykata Supreme e Kosovës, si gjykatë e shkallës së dytë, konsideroi se deklarimet me shkrim e të pandehurit dhe kërkesa e tij verbale "paraqesin një lloj të pranimit të fajësisë por nuk paraqesin prova të reja të cilat mund të merren vetëm në shqyrtim e jo gjatë seancës (neni 412.1 KPPK)," ¹¹ dhe konsideroi se këto deklarime nuk e ndryshojnë gjendjen faktike. Gjatë seancës së apelit më 2009, i pandehuri O [redacted] Z [redacted] vetëm përsëriti se "[është] e vërtetë se më 10 tetor 2005 ka ndodhur një vrasje dhe unë e kam kryer atë vrasje" sa i përket veprës penale, pa dhënë asnjë sqarim të hollësishëm. Përveç kësaj, gjatë shqyrtimit gjyqësor ai kërkoi rigjykim dhe e përmendi gjendjen e tij shëndetësore. ¹² Kolegji i Gjykatës Supreme e refuzoi propozimin për rigjykim. ¹³

18. Në fazën e shkallës së tretë, Gjykata Supreme e Kosovës ka pikëpamje të njëjtë me mbrojtjen në këtë aspekt në kuptimin se "...Gjykata Supreme e Kosovës gjen se shqetësimet e ngritura nga mbrojtja lidhur me këtë janë të bazuara, pasi që pranimi i fajësisë në përputhje me dispozitat përkatëse të KPPK-së kërkojnë që i pandehuri të paralajmërohet dhe të dëgjohet drejt lidhur me versionin e tij se çka ka ndodhur dhe se a e pranon fajësinë veçmas për secilën pikë apo jo, dhe kjo duhet të bëhet gjatë shqyrtimit. Në rastin konkret kjo nuk ishte bërë." ¹⁴ Kolegji pajtohet me gjetjet e shkallës së tretë se "pranimi i fajësisë në kuptim të ligjit duhet të konsiderohet si provë. Kjo ne veçanti sqarohet nga fakti se në përputhje me nenin 315 paragrafët 3 dhe 4 të KPPK-së lidhur me shqyrtimin e konfirmimit (siç përsëritet me nenin 359 paragrafët 2 deri në 5 të KPPK-së për seancën e shqyrtimit gjyqësor) gjyqtari mund të vazhdojë me marrjen e vendimit në rast se ai/ajo është i/e kënaqur me pranimin e fajësisë, përndryshe duhet të zhvillojë tërë procedurën e provave më herët." ¹⁵

19. Gjatë seancës ankimore më 6 nëntor, O [redacted] Z [redacted] përmendi se ishte në gjendje kritike psikologjike dhe fizike gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe se nuk mundi ta shprehte veten. Ai tha se e ka pranuar se ka kryer vrasjen – dhe vrasjen në tentativë – mirëpo, ai nuk e pranon fajësinë. Po ashtu tregon si ka ndodhur ngjarja e 10 tetorit 2005 që mund të përmbliidhen kësisoj: ¹⁶ O [redacted] Z [redacted] dhe [redacted] fqinj. Familja e [redacted] H.R. [redacted] ishte shumë e varfër dhe i pandehuri i ndihmonte ata. [redacted] kishte H.R. njohuri pak a shumë për aktivitetet joligjore të O [redacted] Z [redacted] lidhur me protestat ndaj regjimit serb gjatë viteve 80 dhe në kohën e luftës, dhe filloi presionin ndaj tij. O [redacted] Z [redacted] ishte paraburgosur dhe rrahur drejtpërdrejt nga [redacted]. Në rrethana të H.R.

¹⁰ Dosja e Gjykatës së Qarkut në Prizren. Z [redacted] P nr 155/07 vrasje vol. VIII Apr.08 API – 9/09, AP 110/11: letër nga O [redacted] Z [redacted] e datës 25 tetor 2008

¹¹ Gjykata Supreme e Kosovës, Ap-Kz nr. 481/2009, lënda [redacted] O.Z. Aktgjykim i shkallës së dytë, 21 korrik 2009, faqe 4, par 7

¹² Gjykata Supreme e Kosovës, Ap-Kz nr. 481/2009, lënda [redacted] Z [redacted] procesverbal i seancës, 21 korrik 2009, faqe 13

¹³ Gjykata Supreme e Kosovës Ap-Kz nr. 481/2009, lënda O [redacted] Z [redacted] Aktgjykim i shkallës së dytë, 21 korrik 2009, faqe 20-21, par 31 e më tutje

¹⁴ Gjykata Supreme e Kosovës, Api-Kzi nr. 09/2009, lënda O [redacted] Z [redacted] Aktgjykim i shkallës së parë, 6 dhjetor 2010, faqe 15-16, par 24

¹⁵ Ibid

¹⁶ Gjykata Supreme e Kosovës, Ap-Kz nr. 110/2011, lënda O [redacted] Z [redacted] procesverbal i seancës, 6 nëntor 2012, faqe 13 e më tutje



caktuara ai duhej të shkonte te H [REDACTED] dhe t'i raportonte për aktivitetet dhe shokët e tij. Gjatë luftës çlirimtare, ishte një organizatë e hershme në krye të së cilës ishte vëllai i O [REDACTED] Z [REDACTED]. Më 12 maj 1998, O [REDACTED] Z [REDACTED] ishte plagosur gjatë një beteje frontale dhe veprimtaritë e tij ushtarake përfunduan. Vëllai dhe nipi i tij u vranë gjatë luftës. [REDACTED] ishte drejtpërdrejt përgjegjës për atë periudhë kohore sepse ishte në krye të shërbimit Jugosllav dhe Serb. O [REDACTED] Z [REDACTED] iu nënshtrua trajtimit mjekësor në Tiranë e më pastaj në Zvicër. Pas luftës u kthye në Kosovë. Ai dhe të afërmit e tij të familjes nuk e kishin parë H [REDACTED] në Drenavë përveç familjes së tij më të gjerë. H [REDACTED] dhe forcat serbe ishin tërhequr nga Kosova. O [REDACTED] Z [REDACTED] e vazhdoi jetën e tij normale si biznesmen. H.2.

Në ditën kritike, i pandehuri kishte takime dhe drekoi me drejtorët e Kompanisë Sillos në një restorant në Xërxë. Automobilin e tij e la afër Kompanisë Sillos dhe e përdori në automobil tjetër. Pas dreke, kaloi pak kohë në Kompaninë Sillos dhe pastaj shkoi në drejtim të Prizrenit. U ndal të merrte ca perime për familjen e tij në tregun e gjelbër në Xërxë. Nga Sillosi deri te tregu i gjelbër shkoi me veturë të cilën e parkoi përballë shitores së shokut të tij (N [REDACTED]) afër tregut. Sa ishte duke blerë në treg, e pa drejtpërdrejt Hasan Rustemin dhe vëllain e tij, dhe në atë çast O [REDACTED] Z [REDACTED] "mendova se isha në vijën e frontit në vijën e zjarrit". Pastaj e nxori armën e tij, dhe qëlloi disa herë. Ditët në vijim e kuptoi nga të tjerët se e kishte vranë H [REDACTED]. Para tre/katër muajve vëllai i tij i vogël kishte ndërruar jetë. Armën e mbante për siguri personale. N [REDACTED] nuk e sulmoi ose e keqtrajtoi O [REDACTED] Z [REDACTED]. I pandehuri kurrë nuk dëshoi ta qëllojë. Ai pohon se ishte në gjendje të rëndë mendore dhe O [REDACTED] Z [REDACTED] ishte trajtuar kur shkoi në burg dhe ishte në gjendje shumë të rëndë psikologjike dhe shëndetësore gjatë kohës së gjyqimit.

20. Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës sa i përket fakteve të dhëna nga O [REDACTED] Z [REDACTED] janë nën Pjesën III.C.

III.B. Përgjegjësia penale e të pandehurit O [REDACTED] Z [REDACTED] çështja e gjendjes së tij mendore në kohën e kryerjes së veprave penale

21. Gjykata e shkallës së tretë në aktgjykimin e vet ka arritur në përfundim se i pandehuri O [REDACTED] Z [REDACTED] ishte i afektuar nga një sërë sëmundjesh të ndryshme, si fizike ashtu edhe psikike dhe "[e] tërë kjo së bashku me ekspertizat e dokumentet e tjera nga shkresat e lëndës është dashur ta qojnë gjykatën e shkallës së dytë deri te ekzaminimi *ex officio* i përgjegjësisë penale të të pandehurit në kohën e kryerjes së veprave penale."¹⁷

22. Kolegji i Gjykatës Supreme vështron se pas inicimit të kësaj procedure penale, gjendja mendore e të pandehurit ishte temë e shumë komunikimeve, urdhrave të gjykatës dhe raporteve mjekësore.¹⁸ Vlen përmendur se gjykata e shkallës së parë i ka kushtuar

¹⁷ Gjykata Supreme e Kosovës, Api-Kzi nr. 09/2009, lënda O [REDACTED] Z [REDACTED] Aktgjykim i shkallës së tretë, 26 dhjetor 2010, faqe 23, par 31

¹⁸ Dosja e kaltër gjyqimi për vrasje vëllimi VI, Letër nga doktor N [REDACTED] F [REDACTED] - për [REDACTED] dhe doktor D [REDACTED] - për [REDACTED] - më 5 janar 2008; Letra përmend çrregullimet kronike mendore dhe doktor [REDACTED] - për [REDACTED] gjendja e tij e justifikon transferimin e tij në qendrën klinike universitare në Prishtinë; D [REDACTED] - për [REDACTED] gjyqimi



vëmendje të veçantë kësaj çështjeje, megjithatë të gjitha analizat mbi gjendjen mendore të O [REDACTED] Z [REDACTED] ishin kryesisht të kufizuara për aftësinë e tij për të qëndruar në gjykim, e jo për kapacitetin e tij mendor në kohën e kryerjes së veprave penale.¹⁹ Çrregullimet mendore të të pandehurit ishin vërejtur dhe lajmëruar nga personeli mjekësor i burgut të Dubravës para fillimit të shqyrtimit gjyqësor. Më 10 mars 2008, trupi gjykues përfundoi se, duke u bazuar në konkluzionet paraprake të ekspertëve, O [REDACTED] Z [REDACTED] është fizikisht i aftë për të marrë pjesë në seanca gjyqësore dhe ka kapacitet mendor për ta kuptuar procedurën.²⁰ Në aktgjykim, u arrit përfundim se "[gjatë] tërë fazave të gjykimit, gjykata ishte e njoftuar se Z [REDACTED] ishte mendërisht kompetent dhe i orientuar në të gjitha aspektet ... vështrimi i sjelljes së Z [REDACTED] nga anëtarët të kolegjit gjatë gjykimit dhe gjatë pauzave, që e konfirmuan edhe të tjerët, vërtetoi besimin e gjykatës se apatia e pretenduar e Z [REDACTED] plogështia fizike dhe konfuzioni ishin thjesht pjesë e përpjekjes së tij të vetëdijshme për t'iu shmangur përgjegjësisë për veprat e tij penale më 10 tetor 2005."²¹

23. Në Raportin e Ekspertizës të datës 21 mars 2008 të O [REDACTED] Z [REDACTED] Kosovës, ekspertët përfunduan se O [REDACTED] Z [REDACTED] ka halucinacione hipnagogjike dhe hipnapomprike dhe paraqet simptome të ankthit, periudha të depresionit, paranojës, dhe sjelljes armiqësore. Diagnoza është çrregullim nga stresi post traumatik (ÇSPT).²²


për vrasje vëllimi VI, Raporti mjekësor për O [REDACTED] Z [REDACTED] 12 shkurt 2008, faqe 1639, përmend se gjatë rrugës për në burgun e Dubravës i pandehuri shfaqti disa shenja të çrregullimit mendor; Raporti psikiatrik nga doktor [REDACTED] i datës 16 shkurt 2008, doktori jep këtë diagnozë: çrregullim tipik shizofren i personalitetit F 21. Rekomandimet e tij janë të vendoset nën trajtim të detyrueshëm mjekësor për problemet organike dhe mendore dhe të hospitalizohet për një mendim të pavarur psikiatrik; Raporti i spitalit nga doktor [REDACTED] datës 21 shkurt 2008, faqe 1681: doktori përmend sëmundjen si parregullsi me episode psikotike dhe kërkon që i pandehuri të dërgohet në klinikën universitare në Prishtinë në departamentin e psikiatrisë dhe mjekësisë ligjore.

¹⁹ Dosja e kaltër gjykimi për vrasje vëllimi VI, faqe 1564. Aktvendimi i kryetarit të trupit gjykues i datës 1 shkurt 2008 me të cilin urdhërohet ekzaminimi fizik i O [REDACTED] Z [REDACTED] me qëllim të përcaktimit se a mund të ndikojë gjendja e tij shëndetësore fizike në procedurën në vijim; Urdhri i kryetarit të trupit gjykues i datës 22 shkurt 2008 sipas të cilit duhet të kryhen testet fizike dhe psikiatrike të O [REDACTED] Z [REDACTED] për të siguruar se ai mund të marrë pjesë në gjykim; Dosja e kaltër gjykimi për vrasje vëllimi VI procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 31 janar 2008, faqet 6-10: kryetari i trupit gjykues përmendi komunikimet e dërguara nga doktori i burgut të Dubravës [REDACTED] (rekomandimin për transferimin e O [REDACTED] Z [REDACTED] në qendrën klinike universitare të Prishtinës, në departamentin e psikiatrisë), raporti i datës 9 shtator 2004 ku shënohet se Zyberaj ishte diagnostikuar me çrregullime të depresionit dhe raporti vazhdueshëm mjekësor i datës 28 shtator 2006 me diagnozë të njëjtë; Gjendja e tij shëndetësore ishte objekt i vazhdueshëm i kujdesit shëndetësor gjatë shqyrtimit gjyqësor: shih *në mes tjerë* Dosjen e hirtë, GJQ Prizren Vëllimi VII shkurt 08, procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 21 shkurt 2008, faqet 3-22-26-33, procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 22 shkurt 2008, faqet 4-5-7, procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 6 mars 2008, faqe 3, procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 10 mars 2008, faqe 3, procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 11 mars 2008, faqe 3; Urdhri i kryetarit të trupit gjykues i datës 26 shkurt 2008 për ekzaminimin shëndetësor fizik dhe mendor për përcaktimin e aftësisë së O [REDACTED] Z [REDACTED] për të qëndruar në gjykim; Dosja e hirtë, GJQ Prizren Vëllimi VIII prill 08, procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 15 prill 2008, faqet 11-14; procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 11 prill 2008, faqe 2

²⁰ Dosja e hirtë, GJQ Prizren Vëllimi VIII prill 08, procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 10 mars 2008, faqe 3

²¹ Gjykata e Qarkut në Prizren, P nr. 155/2007, lënda O [REDACTED] Z [REDACTED] Aktgjykimi i shkallës së parë, 17 prill 2008, faqet 17-18

²² Dosja e hirtë, GJQ Prizren Vëllimi VII shkurt 08, Raporti mbi gjendjen mendore të O [REDACTED] Z [REDACTED] 21 mars 2008 nga [REDACTED]



24. Komisioni i ekspertëve të caktuar nga kryetari i trupit gjykues për kryerjen e ekspertizës psikiatrike lëshoi raportin e vet në gusht 2012:

“Bazuar në analizat e dokumentacionit, të dhënave të amnezisë dhe ekzaminimeve psikiatrike dhe psikologjike gjejmë se:

- a) Nuk ekziston asnjë përmbajtje e sëmundjes psikotike ose reagim psikotik
- b) Nuk ekzistojnë elemente të dëmtimit organik të trurit dhe aftësitë intelektuale janë në nivel normal.
- c) Në çastin e ngjarjes erdhi deri te pamundësia për vlerësimin e situatës, duke ndjerë se lufta ende nuk ka përfunduar me një përpjesëtim të çrregulluar të afektit përfshirë frikën dhe urrejtjen që e shtyu të kthehet në kujtimet e luftës.

Në atë çast u paraqit vështirësia e dukshme për ta vlerësuar situatën dhe rrethanat.

E tërë kjo e zvogëloi aftësinë mendore në kohën e kryerjes së veprës penale dhe aftësia për t'i kontrolluar veprimet dhe pasojat e veprimeve të tij në atë moment ishte qartë e zvogëluar.”²³

25. Gjatë seancës ankimore më 6 nëntor, doktor [REDAKTUAR] njëri nga ekspertët e komisionit, dha sqarime shtesë mbi zhvillimin e ekspertizës dhe gjetjet e komisionit. Eksperti përmendi se nuk është gjetur asnjë shënim mbi gjendjen mendore të të pandehurit nga periudha e mëhershme. Ai vazhdoi me krahasimin e raportit të ekspertizës së vitit 2008 me raportin e super ekspertizës së vitit 2012, të dyja të lëshuara nga ekspertët e [REDAKTUAR]

[REDAKTUAR] Ai më tutje sqaroi se O [REDAKTUAR] Z [REDAKTUAR] ka vuajtur nga aftësia e zvogëluar mendore, që mund t'i atribuohet ÇSPT-së por më shumë mund t'i atribuohet veçorive të personalitetit të tij (çrregullimi pasiv-agresiv). Sipas ekspertit, “[ai] ishte në gjendje të tensionuar mendore e cila ia zvogëloi aftësitë për të arritur një përfundim të shpejtë dhe të drejtë se ajo vepër ishte e ndaluar dhe se në atë moment mund ta vriste një njeri të pafajshëm. Ai kishte aftësi të zvogëluar për t'i kuptuar veprimet e veta, kjo quhet pjesa e paqëndrueshme e vullnetit për t'i kontrolluar veprimet dhe këto aftësi ishin të zvogëluara por nuk janë të përjashtuara.”²⁵

26. Megjithatë, ai përmendi se “kontrolli i plotë i veprimeve të tij nuk përjashtohet por ky kontroll dhe gjykim se a ishte veprimi i ndaluar dhe nëse diçka tjetër kishte ndodhur pasi ishte ditë tregu, aftësia për të vepruar dhe aftësia për të gjykuar rëndësinë e veprës. Ekipi i ekspertëve ka marrë parasysh të gjitha rrethanat paraprake se ky person ka një çekuilibër në sferën psiko-sociale dhe ka përjetuar shumë trauma dhe strese, një person i tillë është shumë i thyeshëm në situatë të tillë dhe nuk kishte kontroll dhe gjykim të plotë që veprimi të mos ndodhte.” Përkitazi me ekzistimin e ankthit mendor të O [REDAKTUAR] Z [REDAKTUAR] në kohën kritike (që nuk ishte nënshtruar ekspertizës nga komisioni i ekspertëve), doktori pohoi se i pandehuri ishte nën presion të madh emocional dhe gjendja e tij emocionale

²³ Dosja e kaltër Gjykata Supreme e Kosovës, Ap-Kz nr. 110/2011 – rigjykim – O [REDAKTUAR] Z [REDAKTUAR] Departamenti i Psikiatrisë i [REDAKTUAR] analiza e super ekspertit në lëndën Osman Zyberaj, 31 gusht 2012, faqe 5, versioni në gjuhën angleze

²⁴ Gjykata Supreme e Kosovës, Ap-Kz nr. 110/2011, lënda O [REDAKTUAR] Z [REDAKTUAR] procesverbali i seancës i datës, 6 nëntor 2012, faqe 7: [REDAKTUAR] E lexova dhe e analizova ekspertizën e mëparshme, ato nuk qëndrojnë larg njëra tjetrës. Disa elemente nuk përputhen, për shembull në faqe 2, gjetjet, nuk i kemi gjetur gjërat e njëjta po ashtu përfundimi në faqen e fundit dhe elementet e ÇSPT-së, presioni përfshin traumat brenda 6 muajve – kjo nuk qëndron sepse ÇSPT-ja do të shfaqet madje edhe pas disa vitesh. Përcudnimi pasues është i saktë se ai i kupton akuzat kundër tij, gjetjet e vështruara në faqen e fundit. Ekspertiza jonë potencoi gjendjen e tij mendore në momentin e kryerjes së veprës penale dhe besoj se është një [REDAKTUAR] i gjerë i karakteristikave të personalitetit dhe historisë së tij. Më shumë është thënë lidhur me gjendjen e tij në kohën e kryerjes së veprës penale. Ekspertiza e parë nuk është përqendruar në çështjet e njëjta

²⁵ Ibid, faqe 6



mbizotëroi logjikën e tij, që me gjasë shkaktoi një lloj gjendje të ankthit. Në pyetjen se a paraqet i pandehuri rrezik për shoqërinë, eksperti u përgjigj se ai i është nënshtruar trajtimit psikiatrik në burg dhe se më nuk është i rrezikshëm por duhet të merr barëra kundër-depresionit.

27. Sipas këndvështrimit të Gjykatës Supreme, ekspertët e caktuar për të kryer ekspertizën janë kompetentë dhe ekspertiza psikiatrike e komisionit si dhe sqarimet e doktor [REDAKTUAR] janë bindëse. Për më shumë, kolegji konsideron se dy raportet e ekspertizës nuk dallojnë shumë. Sa do që mund të vërehen disa mospërputhje, kjo duket jo e rëndësishme pasi disa eksplorime më intensive ishin bërë gjatë ekspertizës së dytë. Rrjedhimisht, nuk ka nevojë për ekspertizë të tretë.

28. Rezulton se i pandehuri kishte aftësi ta dallonte paligjshmërinë e veprimit të tij kriminale dhe kishte aftësi të vepronte në mënyrë përgjegjëse. Në anën tjetër, qartë duket se për shkak të personalitetit të çrregulluar dhe ÇSPT-së, aftësia e tij për t'u përmbajtur nga kryerja e veprave penale ishte zvogëluar. Eksperti ka vërtetuar mirë se ÇSPT-ja mund ende të ndikojë në sjelljet individuale edhe pse një kohe të gjatë ka kaluar prej konfliktit në Kosovë dhe kryerjes së veprave penale. Së paku, nuk mund të përjashtohet se rrethanat e përmendura kishin ndikim në sjelljen e të pandehurit. Këto dyshime duhet të interpretohen në dobi të O [REDAKTUAR] Z [REDAKTUAR].

29. Duke marrë parasysh atë që u tha më lart, Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se kur i pandehuri kreu veprat penale të vrasjes dhe vrasjes në tentativë në [REDAKTUAR] në tetor 2005, ai ishte në gjendje emocionale të atillë sa që aftësia e tij për t'i kontrolluar veprimet e tij ishte seriozisht e dobësuar. Kolegji i Gjykatës Supreme prandaj i miraton përfundimet nga raporti i super ekspertizës i muajit gusht 2012. Në kohën kritike O [REDAKTUAR] Z [REDAKTUAR] vuante nga çrregullimet mendore, konkretisht nga varësia e ÇSPT-së. Kjo vërtetohet me anë të deklarimeve të të pandehurit, me sjelljen e tij gjatë procedurës penale, me raportet mjekësore dhe raportet e ekspertizës, të përfshira në shkresa të lëndës, si dhe me deklaratimet e dëshmitarëve.

30. Fakti se aftësia e O [REDAKTUAR] Z [REDAKTUAR] për t'i kuptuar dhe kontrolluar veprimet e tij ishte zvogëluar shumë për shkak të çrregullimit mendor të tij në kohën kritike, me veçori të kapacitetit të zvogëluar mendor, i jep mandat zbatimit të nenit 12 paragrafit 2 të KPPK-së.²⁶ Kjo qon deri te zbritja e dukshme e dënimit në përputhje me nenet 64 dhe 66 të KPPK-së (shih Pjesën III.D. të këtij aktgjykimi më poshtë). Në këtë respekt, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/34 mbi procedurën penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore nuk është e zbatueshme për shkak të faktit se sipas ekspertit, i pandehuri nuk paraqet më tutje rrezik dhe nuk ka nevojë për trajtim të veçantë psikiatrik. Gjendja e veçantë që ka qar deri te kryerja e veprave penale duket të jetë e pazakonshme dhe,

²⁶ Neni 12 paragrafi 2 i KPPK-së Paaftësia mendore dhe aftësia e zvogëluar mendore: (2) Person i cili ka kryer vepër penale konsiderohet se ka aftësi të zvogëluar mendore nëse në kohën e kryerjes së veprës penale aftësia e tij për të kuptuar apo për t'i kontrolluar veprimet a mosveprimet e tij ka qenë dukshëm e zvogëluar për shkak të e cekura në paragrafin 1 të këtij neni. Personi i tillë konsiderohet përgjegjës, por këto rrethana merren parasysh nga gjykata kur vendos për kohëzgjatësinë dhe sanksionit ose masën e trajtimit të detyrueshëm.



përveç kësaj, trajtimi i O [REDACTED] Z [REDACTED] gjatë kohës së kaluar në paraburgim e ka zvogëluar rrezikun e përsëritjes.

III. C. Emërtimi ligjor i veprave të kryera penale

31. Sa i përket veprave penale të vrasjes dhe vrasjes në tentativë, Gjykata Supreme e Kosovës duke vepruar si gjykatë e shkallës së tretë pohon se "... Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se cilësimi juridik i vrasjes së [REDACTED] dhe gjuajtjes dhe plagosjes së [REDACTED] duhet të konsiderojë çështjen e paramendimit dhe dashjes së kryerësit, që nuk është shtjelluar në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë..."²⁷

H.R.
R.R.

32. Trupi gjykues e dënoi O [REDACTED] Z [REDACTED] për vrasje të rëndë në bashkëkryerje në kundërshtim të nenit 147 pikës 5 të KPPK-së ("Privon nga jeta personin tjetër duke vepruar mizorisht e dhunshëm") lidhur me nenin 23 të KPPK-së dhe vrasje të rëndë në tentativë në bashkëkryerje në kundërshtim të nenit 147 pikës 11 lidhur me nenet 20 dhe 23 të KPPK-së. Gjykata e shkallës së dytë, në aktgjykimin e vet Ap-Kz nr 481/2009, e përjashtoi rrethanën e kryerjes nën nenin 147 pikën 5 të KPPK-së dhe, në kuptimin se "dënimi i të pandehurit për dy pika të ndryshme përbën shkelle të ligjit penal në dëm të tij", vendosi t'i bashkojë akuzat e vrasjes së rëndë dhe vrasjes së rëndë në tentativë nga neni 147 pika 11 e KPPK-së.²⁸ Ky vlerësim ligjor nuk mbështetet nga kolegji. Duke marrë parasysh gjendjen faktike dhe gjendjen mendore të O [REDACTED] Z [REDACTED] në kohën kritike, veprat penale nuk mund të cilësohen si vrasje e rëndë në kuptim të nenit 147 të KPPK-së. Ekzistimi i kushteve të nenit 147 pikave 3, 5 dhe 9 nuk mund të vërtetohen. Në veçanti, nuk është vërtetuar se i pandehuri i kishte pritur viktimat, prandaj të shtënat nuk mund të vlerësohen si mashtruese.

33. Sipas mendimit të Gjykatës Supreme, i pandehuri nuk veproi mizorisht dhe dhunshëm. Këto rrethana rënduese të parapara në nenin 147 pikën 5 nuk plotësohen në këtë rast. Qëllimi i ligjbërësit është të sanksionohet vrasja më ashpër kur kryhet në mënyrë të neveritshme. Sjellja e tillë e paskrupullt nuk është e pranishme nëse kryerësi e vret kundërshtarin e tij spontanisht dhe pa paramendim, veçmas kur veproi në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore. Ky arsyetim po ashtu vlen për elementin cilësues të hakmarrjes së paskrupullt nga neni 147 pika 9.

34. Në fund, the kushtet nga neni 147 pika 11 nuk janë plotësuar në lëndën konkrete, pasi që mungon akti objektiv që i pandehuri "të kryejë dy ose më shumë vrasje". Ky pohim vërtetohet me komentaret e Kodit Penal të Serbisë në nenin 47 të përmendur në aktgjykimin e shkallës së tretë. Kolegji i Gjykatës Supreme në veçanti i referohet pjesës së komentareve të versionit më të ri: "kjo vepër penale ekziston vetëm kur së paku dy ose më shumë persona janë të privuar nga jeta. Nëse vetëm një person është i privuar nga jeta dhe një tjetër ishte objekt i tentativës për t'u privuar nga jeta, kjo përbën vetëm vrasje të rëndë në kuptimin e pikës 11 nëse kryerësi paramendoi vrasjen e disa personave;

²⁷ Gjykata Supreme e Kosovës, Api-Kzi nr. 09/2009, lënda O [REDACTED] Z [REDACTED] aktgjykimi i shkallës së tretë, 26 prill 2010, faqe 24

²⁸ Gjykata Supreme e Kosovës, Ap-Kz no. 481/2009, lënda O [REDACTED] Z [REDACTED] aktgjykimi i shkallës së dytë, 21 korrik 2009, faqe 2; faqja 5 e arsyetimit, par 9 e më tutje



përkundrazi, kjo duhet të konsiderohet një pajtueshmëri reale në mes të vrasje e kryer dhe në tentativë".²⁹

35. Në kundërshtim me mendimin ligjor të Mbrojtjes, O [REDAKTUAR] Z [REDAKTUAR] nuk mund të përfitojë nga aplikimi i Nenit 148 të KPPK-së që përcakton se kryerësi ka privuar një person tjetër nga jeta në gjendje të afektit mendor. Tashmë është e diskutueshme se gjendja e tillë ekziston në qoftë se provokimi të pandehurit ka ndodhur vite më parë. Edhe në qoftë se kjo do të konsiderohet për shkak të specifikave të çrregullimit SPT, gjendja e të pandehurit nuk është arritur, "pa fajin e tij ose të saj të vetë". Së fundi, siç vuri në dukje me të drejtë Prokurori i Shtetit, zbatimi i Nenit 148 të KPPK-së është përjashtuar dukshëm për vrasjen në tentativë të [REDAKTUAR] n.r.

36. Lidhur me çështjen e dashjes dhe paramendimit, Gjykata Supreme e Kosovës është e mendimit se megjithëse O [REDAKTUAR] Z [REDAKTUAR] ka vepruar në gjendje të aftësisë të zvogëluar mendor, nuk ka dyshim se ai me dashje ka shtënë në [REDAKTUAR]. Në pajtim me Nenin 15 paragrafin 1 të KPPK-së, një vepër penale mund të kryhet me dashje të drejtë për drejtë apo eventuale. Ligjvënësi përshkruan në Nenin 15 paragrafin 2 dashjen e drejtë për drejtë kur një person, "është i vetëdijshëm për aktin e tij ose të saj dhe dëshiron kryerjen e tij". I pandehuri ishte plotësisht në dijeni të faktit se ai qëlloi dy persona me qëllim vrasjen e tyre. Edhe duke pasur parasysh deklaratën e tij në gjykatë se ai ndjehej i transferuar përsëri në kohën e luftës, ai kishte gatishmërinë për të vrarë kundërshtarët e tij të supozuar me armën e tij duke e ditur se të shtënat prej një distance të shkurtër do të kenë probabilitet të lartë për të shkaktuar vdekjen e personave të sulmuar. Të paktën, ai ka vepruar me dashje eventuale në kuptim të Nenit 15 paragrafit 3 të KPPK-së, duke qenë i vetëdijshëm se mund të ndodhin pasoja të ndaluara dhe ai ka aderuar në ndodhjen e tyre. Së fundi, kolegji i Gjykatës Supreme mendon se veprat penale të Vrasje dhe Vrasje në tentativë sipas Nenit 146 të KPPK-së nuk kërkojnë paramendim. H.R. n.r.

37. Duke pasur parasysh këto më sipër, në veçanti deklaratën e të pandehurit, Gjykata Supreme modifikoi emërtimin ligjor të veprave si në dispozitiv: Më 10 tetor 2005 rreth orës 16:20 në tregun e fshatit Xerxe, komuna e Prizrenit, O [REDAKTUAR] Z [REDAKTUAR] duke vepruar në marrëveshje me bashkëkryerës të panjohur me synim për të privuar qëllimisht nga jeta një person tjetër, respektivisht [REDAKTUAR] me dashje ka shtënë në dhe ka vrarë [REDAKTUAR] dhe me synim për tu përpjekur qëllimisht të privoj nga jeta një person tjetër, respektivisht [REDAKTUAR], me dashje ka shtënë në dhe plagosi [REDAKTUAR]. O [REDAKTUAR] Z [REDAKTUAR] ka kryer dy vepra penale të ndara të Vrasje nën Nenin 146 të KPPK-së dhe Vrasje në Tentativë nën Nenin 146 të lexuar me Nenin 20 të KPPK-së, në bashkë-kryerje nën Nenin 23 të KPPK-së. Gjendja mendore e të pandehurit në kohën e kryerjes kërkon zbatimin e Nenit 12 paragrafit 2 të KPPK-së. H.R. n.r.

38. Lidhur me veprën penale të Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të Nenit 328 Paragrafi 1 të KPPK (i ndryshuar nga gjykata e shkallës së dytë në Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim

²⁹ Komentimet e Kodit Penal të Serbisë, Neni 47, Srzentic Nikola Ljubisa Lazarevic 1995 Savremena Administracija, Beograd, pika 9 – theksim i shtuar



apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të Nenit 328 Paragrafi 2 të KPPK), Gjykata Supreme konsideron se përdorimi i armëve është përfshirë nën veprat Vrasje dhe Vrasje në tentativë. Ky kolegji konfirmoi vendimin e fajësisë për pikën 4 (Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të Nenit 328 Paragrafi 2 të KPPK), pasi që ishte në posedim të një arme për të cilën nuk kishte autorizim ta mbante apo shfrytëzonte kur u arrestua nga Policia në prill 2007.

III.D. Vendimi mbi sanksionet penale

39. Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me përgjegjësinë penale të O [REDACTED] dhe cilësimin ligjor dallojnë nga ato të më hershme, vendimi mbi sanksionet penale duhet të rishqyrtohet.

40. Është vërejtur se në shkallën e parë i pandehuri u dënua me njëzet e pesë vjet burgim për Vrasje të Rëndë, me njëzet e pesë vjet burgim për Vrasje e Rëndë në Tentativë, me gjashtë dhe tri vjet burgim për akuzat për armë (dy pika). Dënimi unik i shqiptuar ishte njëzet e pesë vjet. Ky dënim nuk u modifikua nga gjykata e shkallës së dytë në aktgjykimin e saj të vitit 2009.

41. Kolegji i Gjykatës Supreme merr në konsideratë për dhënien e dënimit se vepra penale ishte ri-klasifikuar. Për më tepër, ka rrethana lehtësuese p.sh. pranimi i fakteve nga i pandehuri dhe se ai ka vepruar derisa ishte në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendor sikurse parashihet nën Nenin 12 paragrafin 2 të KPPK-së. Lidhur me rrethanat rënduese, ato janë me sa vijon: rëndësia dhe pesha e veprave të Vrasje dhe Vrasje në tentativë, fakti që ato ishin kryer në një zonë të dendur, fakti që O [REDACTED] Z [REDACTED] ishte gjetur në posedim të armëve në kohën e arrestimit të tij.

42. Gjykata Supreme e Kosovës e dënoi të pandehurin me katëmbëdhjetë vjet burgim për pikat 1 dhe 2 dhe me dy vjet burgim për pikën 4, dhe shqiptoi një dënim unik prej pesëmbëdhjetë vjet burgim në pajtueshmëri me Nenin 71 të KPPK-së. Sipas mendimit të këtij kolegji, ky lloj i dënimit korrespondon me qëllimin e ndëshkimit të paraparë në Nenin 34 të KPPK-së.

43. Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që koha e kaluar në paraburgim nga O [REDACTED] Z [REDACTED] që nga 19 prill 2007 të llogaritet në pajtueshmëri me Nenin 73 të KPPK-së, dhe refuzon si të pabazuar propozimin e Mbrojtjes të ushtruar më 6 nëntor 2012 për të ndërprerë paraburgimin për O [REDACTED] Z [REDACTED]

44. U vendos si në dispozitiv.

Kryetari i kolegjit

Horst Proetel, gjyqtar i EULEX-it

Anëtare e kolegjit

Emine Kaqiku, gjyqtare e Gjykatës Supreme të Kosovës



Anëtar i kolegjit

Avdi Dinaj, gjyqtar i Gjykatës Supreme

Anëtare e kolegjit

Marije Ademi, gjyqtare e Gjykatës Supreme

Anëtar i kolegjit

Tore Thomassen, gjyqtar i EULEX-it

Procesmbajtësja

Chiara Rojek, Zyrtare Ligjore e EULEX-it

Gjykata Supreme e Kosovës

Ap-Kz nr. 110/2011

Prishtinë

